REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 8389/2 Prot. Tiranë, më 10.11.2026

URDHËR

Nr. 536, datë 10.11.2026

PËR
DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 400, DATË 31.07.2026 "PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË PROGRAMIT "PAS SHKOLLE", STANDARDEVE, KRITEREVE, PLANIT TË VEPRIMIT PËR OFRIMIN E KËTIJ PROGRAMI, SI DHE PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 4, të nenit 47/1, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 579, datë 11.11.2025 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Herida Duro",

URDHËROJ:

1. Shtojcat nr. 1 dhe nr. 5 në urdhrin nr. 400, datë 31.07.2026 "Për miratimin e llojeve të programit "pas shkolle", standardeve, kritereve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar ku zhvillohet programit", zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale dhe vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

Herida Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT